

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



MUAJI I RAMAZANIT
SHKOLLË SHPIRTËRORE
E JETËS

Tiranë, 2023

Titulli: **Muaji i Ramazanit shkollë shpirtërore e jetës**

Autori: **Imam Sejid Ali Khamenei**

Përktheu: **Haxhi Sheh Vullnet Merja**

Redaktoi: **Jerida Kulla**

Korrekttoi: **Vjollca Karaj**

Përkujdesja kompjuterike & Kopertina: **Sabrie Feza**

Botues: **Shoqata "Fladi"**

MUAJII RAMAZANIT SHKOLLË SHPIRTËRORE E JETËS

Në një prej ligjëratave të tij, imam Sejid Ali Khamenei ka folur për devotshmërinë dhe ndikimet e saj te njeriu.

Teksti i ligjëratës është si vijon:

Në Librin e Allahut thuhet: **“O ju që keni besuar! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat”**.¹

Sipas këtij ajeti të Kur’anit, qëllimi i agjëritimit të muajit të Ramazanit është devotshmëria dhe shtimi i këtij thesari të madh shpirtëror te njeriu. Dimë se namazi dhe zekati nuk ishin të veçanta vetëm për umetin islam. Përkundrazi, Profetët dhe të Dërguarit që i paraprinë të Dërguarit të Islamit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e kanë pasur namazin dhe zekatin në krye të dispozitave të tyre. Për shembull, në ajetin 31 të sures “Merjem” thuhet: **“Më ka porositur që sa të jem gjallë, të**

¹Sure “El Bekare”, ajeti 183.

falem dhe të jap zekatin.”. Kështu u tha Profeti Isa (*Paqja qoftë mbi të!*) bijve të Izraelit.

Pra, siç përftohet nga ajete të tjera të Kur’anit, agjërimi, ashtu si namazi dhe zekati, janë dispozita që nuk janë të veçanta për umetin islam, sepse edhe kombet e mëparshme dhe Profetët e mëparshëm u urdhëruan të agjëronin.

Ky është tregues se agjërimi është i domosdoshëm dhe i detyrueshëm dhe paraqet një nga bazat kryesore të përsosmërisë dhe të lartësimit shpirtëror të njeriut; ashtu siç është i domosdoshëm namazi, pasi paraqet marrëdhënien shpirtërore ndërmjet njeriut dhe Allahut të Madhëruar.

Devotshmëri (takua) do të thotë ruajtje e vetëdijes shpirtërore

Agjërimi është një shkallë për t'u ngjitur drejt devotshmërisë. Është një mjet për ta përvetësuar devotshmërinë në qeniet tona. Devotshmëria ka kuptimin që njeriu të vëzhgojë, të ruajë e të mbikëqyrë sjelljet dhe veprimet e tij, me qëllim që Allahu të jetë i kënaqur me të. Kjo mbikëqyrje dhe kjo ruajtje quhet "tekua".

Devotshmëri do të thotë të vëzhgosh sjelljen tënde, që të mos bësh asgjë që bie ndesh me urdhrat dhe ndalesat e Allahut të Madhëruar. Ky është kuptimi i devotshmërisë. Ndonjëherë, një person mund të humbasë kontrollin e gjërave dhe mund të kryejë një mëkat të caktuar. Ajo që ka rëndësi, është të kujdeseni dhe të vendosni, që të mos bëni asgjë të keqe e të dëmshme. Ky është shpirti i devotshmërisë dhe i vetëdijes. Kur të jeni zgjuar, të vetëdijshëm dhe të vëzhgoni veten, do të jeni të vetëdijshëm edhe për armikun tuaj.

Kur jeni të vëmendshëm ndaj djallit brenda jush, atëherë do t'i kushtoni vëmendje edhe djallit të jashtëm. Kur

djalli i brendshëm nuk mund t'ju dëmtojë, edhe djalli i jashtëm, gjithashtu, nuk do të jetë në gjendje t'ju kontrollojë dhe t'ju godasë.

Ky është mesazhi i muajit të Ramazanit. **“O ju që keni besuar! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat.”**² Pra, qëllimi është devotshmëria.

² Sure “El Bekare”, ajeti 183.

Dobitë e devotshmërisë në shoqërinë njerëzore

Shoqëria e devotshme zgjedh me saktësi dhe kujdes rrugën e Allahut. Jo vetëm kaq, por ajo e ndjek me përpikëri atë, në mënyrë që të gëzojë bekimet hyjnore dhe të fitojë dinjitet në këtë jetë. Allahu e frymëzon atë me dituri dhe njohje. Një shoqëri që ecën në rrugën e devotshmërisë, do të ketë një atmosferë të shëndoshë, plot dashuri. Anëtarët e saj do të mbështetin, do të përkrahin dhe do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin gjatë rrugëtimit të tyre jetësor.

Devotshmëria është çelësi i lumturisë së kësaj bote dhe Botës së Përtejme. Qeniet njerëzore që i largohen kësaj rruge, ankohen për të gjitha llojet e vështirësive dhe dhimbjeve personale dhe shoqërore, paguajnë çmimin e mungesës së devotshmërisë, neglizhencës, mungesës së vëmendjes dhe mbytjes në moçalin e epsheve. Fati i shoqërive të prapambetura është gjithashtu i qartë.

Shoqëritë e zhvilluara në botë, megjithëse janë të lumtura në disa aspekte dhe kjo rrjedh edhe nga vetëdija dhe zgjimi në disa aspekte të jetës, vuajnë nga mangësi dhe zbrazëti fatale, ku shkrimtarët, predikuesit dhe artistët e tyre e deklarojnë këtë, sot, në një mijë stile dhe mënyra.

Devotshmëria është porosia e parë dhe e fundit e Profetëve. Në shumë sure të Kur'anit ju lexoni se këshilla e parë që Profetët u dhanë njerëzve, ishte devotshmëria.

Kur gjendet devotshmëria, gjendet edhe udhëzimi i Allahut. Kurdo e kudo që nuk ka devotshmëri, udhëzimi i Allahut nuk është i plotë te individi dhe shoqëria. Agjërimi është parakushti i devotshmërisë.

Vërtet, muaji i Ramazanit është mundësia më e mirë për t'u afruar te Allahu i Madhërishëm. Padyshim që jeta, në klimën e afërsisë me Allahun, është një jetë krejtësisht e ndryshme! Muaji i Ramazanit është një stacion shpirtëror dhe një takim i shenjtë në tryezën e mëshirës së Allahut.

Kushdo që është përgatitur dhe i ka kryer adhurimet në muajt Rexheb dhe Sha'ban, duke agjëruar, duke falur namaz, duke përmendur Allahun dhe duke kënduar Kur'anin, vazhdon rrugëtimin për t'u përgatitur për tryezën e madhe, atë të muajit të Ramazanit.

Nëse njeriu e pret muajin e Ramazanit me pendim të vërtetë, atëherë kjo do të jetë si një kartë hyrjeje në mikpritjen e Allahut të Gjithëmëshirshëm, e cila është larëse e mëkateve, e përgatitur për pastrimin e shpirtit, si rrjedhim, e bën njeriun të jetë gati për të pritur dhëniet dhe begatitë e shumta ndriçuese të Allahut.

Muaji i begatë i Ramazanit vjen një herë në vit. Kushdo që hyn në të, në mënyrë të improvizuar, pa plan, ose nuk ka një program të përpunuar dhe të pamenduar mirë, edhe pse beson në shenjtërinë e këtij muaji, ai nuk do të përfitojë prej tij përfitimin e dëshiruar.

1- Ne duhet të planifikojmë, që të jemi më të mirë pas Ramazanit, se sa kemi qenë para tij.

2- Të përcaktojmë disa çështje, të cilat duam t'i përmirësojmë. Askush të mos mendojë se ai mund të përmirësohet menjëherë në gjithçka. Për shembull, të përcaktojmë katër gjëra, të cilat duam t'i përmirësojmë, duke supozuar se nuk i bëjmë ato, ose nuk i bënim rregullisht para Ramazanit. Ato katër gjëra janë:

- 1- Namazi në fillim të kohës;
- 2- Lëmoshë ditore;
- 3- Falja e namazeve ditore në xhami;
- 4- Namazet e natës.

3- Qëllimet duhet të jenë të përcaktuara. Ato që arrihen më shumë, janë ato që nguliten në mendje. Duhet të dihet qartë rruga e arritjes së qëllimeve.

4- Ne duhet të shkruajmë planin për muajin e Ramazanit, para se të vijë dhe ta rishikojmë disa herë, ta përmirësojmë, ta ripërtërijmë qëllimin tonë dhe ta pastrojmë përkushtimin tonë ndaj Zotit të Madhërishëm.

SHOQËRIMI ME KUR'ANIN

Imam Sejid Ali Khamenei në fjalimet e tij i kushton shumë rëndësi Kur'anit Famëlartë dhe fton në mësimin e tij dhe në zbatimin e tij në jetën e përditshme. Në veçanti ai fton rininë që të kapen e të shoqërohen me Kur'anin. Një prej fjalimeve të tij në lidhje me Kur'anin është si më poshtë:

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: *“Kushdo që ulet me këtë Kur'an, do ngrihet prej tij me shtim ose me mangësi. Shtim në udhëzim, ose mangësi në verbëri”*.

Kur'ani Famëlartë ka zënë një vend të madh në zemrat e besimtarëve, që nga shpallja e tij në zemrën e Profetit më fisnik (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ata e lexuan atë dhe iu përmbajtën atij. Organizonin tubime, për të reflektuar mbi ajetet e tij të bekuara, për t'i tërhequr zemrat e tyre drejt Krijuesit të Madhëruar e të Lartësuar dhe për të kujtuar shenjat e Allahut në këtë botë dhe në Botën Tjetër.

Allahu i Madhëruar i shpërblen shumë ata që i përmbahen këtij Libri Fisnik, që e lexojnë, i mësojnë përmendësh ajetet e tij, kujdesen për çështjet e tij, veprojnë sipas tij dhe e mësojnë atë. Ai përmban elemente shkencore,

morale, edukative e të tjerë, të cilat kontribuojnë në ndërtimin e jetës së individit dhe të shoqërisë në të gjitha nivelet dhe fushat e jetës.

Imam Khamenei (*Allahu ia shtoftë jetëgjatësinë!*) e ka bërë Kur'anin pjesë të jetës, jo vetëm duke i vënë në zbatim dijet e marra prej tij, por edhe të udhëheqë sipas parimeve të Librit të Allahut. Fjalimet, shkrimet e tij janë orientim për të gjithë.

Po japim pjesë nga fjalimi i tij:

“Të dashurit e mi!

Kur'ani është dritë. Ai ndriçon zemrën dhe shpirtin. Nëse shoqëroheni me Kur'anin, do të shihni se si do t'ju ndriçohet zemra dhe shpirti. Me bekimin e Kur'anit, shumë errësira dhe perde largohen nga zemra dhe shpirti i njeriut. Me mirësitë e Kur'anit, njeriu del nga errësitat e iluzioneve, gabimeve, rrëshqitjeve dhe dyshimeve, duke ecur në dritën e udhëzimit.

Rruga e shpëtimit për të gjithë popujt islamë është afrimi me Islamin dhe me Kur'anin. Nëse një komb është në gjendje të jetojë me atmosferën kur'anore dhe të fitojë prej dijes kur'anore, do të jetë në gjendje të kapërcejë problemet që i dalin. Problemi më i madh nga i cili vuajnë myslimanët,

është largimi nga Kur'ani. Ilaçi i problemit është kthimi te Kur'ani.

Kur'ani është det i thellë, i paanë. Sado larg të udhëtosh, qoftë në sipërfaqe apo në thellësi të tij, prapëseprapë ekziston mundësia e lëvizjes, e përparimit. Sa më shumë të ecni përpara me Kur'anin, aq më shumë etje dhe dëshirë do të keni për të dhe zemrat tuaja do të jenë më të ndritshme.

Në lidhje me këtë çështje, Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: *“Pamja e tij është elegante, kurse e brendshmja e tij është e thellë”*. Fjala *“enijkum”* ka kuptimin e bukurisë mahnitëse, një bukuri që të habit dhe të mahnit, kur e sheh dhe e ndesh. E tillë është bukuria në Kur'an.

Të dashurit e mi, Kur'ani është dritë që ndriçon shpirtin dhe zemrën. Nëse shoqëroheni me të, do të shihni se zemra dhe shpirti juaj është i ndriçuar. *“Ai është drita e qartë”*. (Hadith profetik).

Cila është karakteristika e dritës? Drita ndriçon atmosferën dhe e drejton personin të ecë i sigurt në rrugën e tij. Përmes dritës, njeriu fiton jo vetëm aftësinë për të parë, por edhe vigjilencën. Nëse nuk ka dritë, sytë nuk do të punojnë dhe nuk do të ketë asnjë përfitim prej tyre, sepse ata nuk do të shohin asgjë.

Ne kemi intelekt, kemi aftësi të ndryshme, kemi aftësi mendore, por pa dritë, këto aftësi nuk do të mund të na ndihmonin. Drita është e nevojshme, prandaj Kur'ani është jeta jonë. Ai është fener i Islamit dhe i udhëzimit.

Kur'ani dëshiron që myslimanët të jenë vigjilentë. Përballë vullnetit hyjnor dhe kur'anor qëndron vullneti i të dehurve nga pushteti dhe i robërve të epshit. Ajeti 26 i sures "En Nisa" shpjegon vullnetin e Zotit: **"Allahu dëshiron që t'ju sqarojë, t'ju udhëzojë në rrugën e të Dërguarve të mëparshëm dhe t'jua pranojë pendimet tuaja. Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë."** Kjo do të thotë se Allahu dëshiron t'ju udhëzojë dhe t'ju tregojë Rrugën e Drejtë, t'ju ndriçojë dhe t'ju bëjë të vetëdijshtëm.

Në ajetin që pason, Allahu i Plotfuqishëm sqaron vullnetin e kundërt: **"Allahu dëshiron që t'jua pranojë pendimet tuaja, por ata që jepen pas epsheve, dëshirojnë që të largoheni krejtësisht nga Udhë e Drejtë."**³ Pasuesit e epshit duan që ju të devijoni plotësisht. Ata që janë të dehur nga pushteti dhe epshi, janë të shkujdesur dhe duan që edhe ju të jeni si ata, të pakujdesshtëm dhe të humbur. Pra, të fuqishmit dhe mendjemëdhenjtë në botë, që kanë pushtet, epsh, pozitë dhe të gjitha arsyet e neglizhencës së bashku, sa herë që takojnë njerëz vigjilentë, të cilët udhëhiqen nga

³ Sure "En Nisa", ajeti 27.

udhëzimi ndriçues hyjnor, dëshirojnë të jenë si ata, të shkujdesur dhe të devijuar nga rruga e drejtë.

Zoti na bekoi ne si popull dhe na zgjoi. Edhe ne, para kësaj, ishim në gjumin e pakujdesisë, të paudhëzuar, nën regjimet tiranike dhe mbretërore të shkatërrimit. Edhe ne po largoheshim nga morali islam, por Allahu na zgjoi dhe na ndriçoi zemrat.

O të rinj, që po dëgjoni këtë bisedë, dini se në Kur'an ka urtësi, dritë dhe shërim. Urtësia kur'anore mund t'i zgjidhë të gjitha nyjet e krijuara nga konfliktet që ekzistojnë në botën e materies në zemrën dhe shpirtin e njeriut. Kjo është e vërtetë. Kur'ani hap zemrën, hap gjoksin, jep shpresë, jep dritë dhe gjeneron besimin e fortë, që e udhëzon njeriun drejt Rrugës së Drejtë.

Ne duhet të kapemi me Kur'anin dhe t'i përmbahemi atij. Sot ne kemi nevojë për Kur'anin, qoftë në jetën tonë personale apo shoqërore, qoftë në sjelljen tonë politike apo qeveritare. Kur'ani na jep frymë dhe njohuri.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: *"Kushdo që ulet me këtë Kur'an, do ngrihet prej tij me shtim e me mangësi. Shtim në udhëzim, ose mangësi në verbëri"*.

Kur të ngriheni nga prania e Kur'anit, të është shtuar diçka, të është shtuar udhëzimi. Diçka të është hequr. Ajo është verbëria dhe injoranca. Kjo ndodh, kur ulesh me

Kur'anin, kur e zbaton atë. Sigurisht, kjo ndodh edhe kur ai përsiatet dhe i kushtohet vëmendje. Kur'ani duhet të lexohet me përqendrim dhe të jeni të vetëdijshëm, se nuk kërkohet thjesht formimi i tingujve gjatë leximit, por Kur'ani duhet të lexohet me vëmendje, për të përvetësuar kuptimet dhe qëllimet e tij. Nëse kjo ndodh, bashkësia islame do ta gjejë rrugën e saj sepse Allahu është Kujdestari i atyre që kanë besuar siç thotë në suren Bekare, ajeti 257: **“Allahu është Kujdestari i atyre që besuan, Ai i nxjerr ata nga errësirat në dritë.”**. Ai e nxjerr njeriun nga errësira e besëtytnive, nga errësira e humbjes, nga errësira e frikës dhe e iluzioneve, në dritën e udhëzimit, në dritën e diturisë, në dritën e afrimit me Allahun dhe në dritën e kënaqësisë me Krijuesin. Këto veçori shfaqen dhe lindin nga qëndrimi me Kur'anin dhe shoqërimi me të. Kjo është ajo që na nevojitet. Kjo është ajo që sot i duhet umetit islam.

Një nga pikat e rëndësishme në punët hulumtuese kur'anore është se kushdo që dëshiron të përshkojë rrugën praktike kur'anore, duhet të përgatisë zemrën e tij për t'u përballur me të vërtetën e pastër kur'anore, që është pastrimi i zemrës. Nëse zemra nuk është e pastër dhe nuk është e gatshme të pranojë të vërtetën nga gjuha e Kur'anit, nëse është e lidhur me themelet joislame dhe jo hyjnore, atëherë, kur ajo zemër t'i drejtohet Kur'anit, asgjë nuk do të fitojë prej tij. E po, pse humbja me Kur'anin? Udhëzimi nga Kur'ani është i qartë, por pse humbja me të? Arsyeja është kjo: **“E për sa u përket atyre, në zemrat e të cilëve ka**

sëmundje, ajo ua shton ndyrësinë në ndyrësitat e tyre.”⁴
Pra, në zemrat e sëmura të tyre, kur lexojnë Kur’anin, ndyrësia që është brenda tyre u shtohet. Ajeti ose surja kur’anore ua shton ndyrësinë. Pra, çfarë është kjo e neveritshme? Dhe çfarë është kjo sëmundje? Ato janë sëmundjet morale.

Kur të na godasë zilia dhe vështirësitë për këtë botë, kur të na pushtojnë epshet dhe kërkimi i pushtetit, kur të na pushtojë armiqësia për të vërtetën, shpërfillja e fshehja e të vërtetës, atëherë nuk do të kemi dobi nga Kur’ani. Do të marrim nga Kur’ani të kundërtën e asaj që duhet të na japë. Zotit i duhet kërkuar mbrojtje!

I shihni se disa prej tyre, ndonjëherë, lexojnë ajetet e Kur’anit për të goditur Islamin, për të rrëzuar Republikën Islamike dhe për të zhdukur virtytet që na ka ofruar Republika Islamike.

Afrimi të Kur’ani duhet të jetë me pastërti, që drita e Kur’anit dhe përkujtimi kur’anor të ndikojë në zemrat tona dhe të kemi dobi prej tij, në dashtë Allahu.

⁴ Sure “Teube”, ajeti 125.

DITA E KUDSIT, DITA E UNITETIT TË MYSLIMANËVE

Me emrin e Zotit, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve. Paqja dhe bekimet qofshin mbi zotërinë dhe krijesën më të nderuar, zotërinë tonë Muhamed Mustafanë, vulën e të Dërguarve, mbi familjen e tij të pastër, shokët e tij të zgjedhur dhe mbi ata që i pasojnë ata në mirësi, deri në Ditën e Gjykimit.

Imam Sejid Ali Khamenei i kushton vëmendje të madhe çështjes së Palestinës dhe të Xhamisë Aksa. Në një prej fjalimeve të tij ai ka thënë:

Dita Botërore e Kudsit na erdhi përsëri. Kudsi i shenjtë u bën ftesë të gjithë myslimanëve në botë. Të gjitha ditët e vitit duhet të konsiderohen si Dita e Kudsit. Kudsi i shenjtë është zemra e Palestinës.

Populli palestinez, me një madhështi të pashoqe, tregon qëndrueshmërinë e tij. Ai qëndron përballë

padrejtësisë dhe do të qëndrojë gjithmonë i palëkundur. Të rinjtë palestinezë, me sakrificat e tyre, janë bërë mburojë mbrojtëse për Palestinën dhe paralajmërojnë një të ardhme premtuese.

O ju bijtë e Palestinës, ju rinia sakrifikuese në Bregun Perëndimor dhe në tokat e vitit dyzet e tetë! Ju luftëtarët në kampin e Xhenijnit dhe ju që jetoni në kampet palestineze në diasporë! Ju përbëni pjesën më të rëndësishme, më të ndjeshme dhe më pioniere në trupin e rezistencës. Dijeni se: **“Me të vërtetë, Allahu i mbron ata që kanë besuar”**.⁵

Dhe: **“...nëse duroni, kjo është më e mira (rrugë) për të durueshmit”**.⁶

Dhe: **“...Por, nëse ju duroni dhe ruheni (nga të këqijat), atëherë kjo është vërtet përcaktuese e çështjeve”**.⁷

Dhe: **“Paqja qoftë mbi ju, për durimin që keni treguar (në jetën e kësaj bote)”**.⁸

Palestina dhe Jerusalemi përmenden në Kur'anin e Shenjtë si “Toka e shenjtë”. Për dekada të tëra, kjo tokë e pastër ka rënë nën thundrën e qenieve njerëzore më të pista e më të liga. Këta djaj derdhin gjakun e të nderuarve dhe më pas e pranojnë dhe e pohojnë me paturpësinë më të madhe.

⁵ Sure “Haxhxh”, ajeti 38.

⁶ Sure “En Nahl”, ajeti 126.

⁷ Sure “Ali Imran”, ajeti 186.

⁸ Sure “Er Rra’ad”, ajeti 24.

Ata që kanë vrarë, kanë plaçkitur, kanë burgosur dhe kanë torturuar pronarët e tokës, për më shumë se shtatëdhjetë vjet, janë racistë, por, falë Zotit, nuk mundën ta thyejnë vullnetin e tyre.

Çështja e Palestinës vazhdon të jetë çështja më e rëndësishme dhe më e gjallë në mesin umetit islam. Sistemi kapitalist, i padrejtë dhe vrasës, planifikoi që të privojë një popull nga pasuria dhe nga atdheu i baballarëve e i gjyshërve të tij, për të vendosur, në vend të tij, një entitet terrorist dhe njerëz të çuditshëm, me horizonte anormale.

Palestina është e gjallë, e vazhdon xhihadin e saj dhe, me ndihmën e Zotit, në fund do ta mposhtë armikun keqdashës. Kudsi i nderuar dhe e gjithë Palestina, i përket popullit palestinez dhe do t'u kthehet atyre, me dëshirën e Zotit. Kjo nuk është e pamundur për Zotin. Palestina, siç e kemi thënë vazhdimit, ndodhet midis lumit Jordan dhe detit Mesdhe. Kjo është Palestina. Pa dyshim që Kudsi (Jerusalemi) është kryeqyteti i saj.

Çështja nuk ka lidhje me armiqësinë ndaj jehudive, sepse, jehudinjtë, ashtu siç jetojnë sot në paqe e në siguri, nën hijen e Republikës Islamike të Iranit, po ashtu mund të jetojnë në paqe, nën hijen e udhëheqjes islame në Kuds (Jerusalem).

Sigurisht, banorët e Kudsit nuk janë të gjithë myslimanë, por shumica e tyre janë myslimanë. Është e

mundur që myslimanët, të krishterët dhe jehudinjtë të jetojnë në harmoni me njëri-tjetrin në qytetin e Kudsit. Ne besojmë se shtetet islame duhet të lëvizin me seriozitet kundër Sionizmit. Pra, çështja nuk ka të bëjë me armiqësinë ndaj jehudinjeve, por ka lidhje me pushtimin e shtëpive dhe vendbanimeve myslimane.

Çështja e Jerusalemit (Kudsit) është çështja jonë e vjetër dhe ne e kemi thënë vazhdimisht se është çështja jonë strategjike. Ne nuk flasim ndonjëherë për Jerusalemin, për interesin tonë. Për ne, Jerusalemi është si qyteti i Teheranit dhe Mashhadit. Ai është shtëpia jonë dhe nuk pretendojmë pronësinë e Jerusalemit. Nuk lejojmë që këto fjalë: “Irani dëshiron Jerusalemin”, të merren si pretekst. Më duket se në konferencën “Fas” u tha se Irani kërkon të pushtojë Jerusalemin! Ata janë vëllezërit tanë dhe janë myslimanë. Qyteti i Jerusalemit është i popullit të Jerusalemit dhe ai është një qytet islam. Ashtu siç i konsiderojmë Isfahanin, Shirazin, Teheranin dhe Mashhadin, të cilët ishin në duart e armikut, qytete islame, për të cilët ne u përpoqëm t’i nxjerrim jashtë sundimit të tyre, po kështu dëshirojmë edhe për qytetet e Palestinës, Jerusalemit dhe të gjitha qytetet ekzistuese. Ne themi se ato janë qytete islame, që ranë nën kontrollin e armiqve të Islamit, prandaj duhet të hiqen nga duart e tyre dhe t’i jepen popullit të tyre.

Populli iranian, siç ka qenë gjithmonë, e sheh veten në anën e kryengritësve palestinezë. Populli iranian beson se fitorja e tyre është e paplotë pa fitoren e çështjes

palestineze. Imami i ndjerë e i madh, Imam Khomeini, që në ditët e para të kryengritjes së tij në Iran, e vendosi çështjen palestineze në krye të listës së vëmendjes së tij. Ai e ndoqi këtë çështje jo vetëm gjatë ditëve të Revolucionit, por edhe pas fitores së Revolucionit.

Detyra e umetit islam në Ditën e Kudsit

Nuk ka absolutisht asnjë ndryshim në mesin e të gjitha shkollave të njohura të mendimit islam dhe se të gjithë juristët kanë mendim të përbashkët, se kur një pjesë e tokës islame pushtohet nga armiqtë dhe ata armiq të Islamit e pronësojnë atë tokë, atëherë, të gjithë duhet ta konsiderojnë xhihadin dhe përpjekjen për ta kthyer atë pjesë toke në tokën islame si detyrë të tyre. Prandaj, popujt myslimanë, kudo që janë në botë, duhet ta konsiderojnë këtë çështje detyrë të tyre. Sigurisht, shumë njerëz mund të mos jenë në gjendje të bëjnë diçka dhe të ndërmarrin një nismë të veçantë, por secili duhet të punojë me aq sa mundet dhe aq sa ka mundësi. Për këtë arsye, e gjithë bota islame përkujton Ditën e Kudsit, të cilën e shpalli imami i madh, Imam Khomeini, që të jetë çdo vit, të premtën e fundit të muajit të Ramazanit.

Dita e Kudsit nuk është diçka e veçantë vetëm për Iranin. Ajo është dita botërore islame. Kështu që myslimanët, në mbarë botën islame, kur përkujtojnë Ditën e Kudsit, kanë shënuar praninë e tyre për të mbrojtur vëllezërit e tyre palestinezë. Në këtë ditë, myslimanët tregojnë vullnetin e tyre të përgjithshëm për t'u përballur

me kurthet e Amerikës dhe të Izraelit në Palestinën e shtypur dhe të gjakosur.

Përkujtimi i detyrës së popujve myslimanë

Ardhja e Ditës Botërore të Kudsit u kujton myslimanëve të zellshëm të botës, edhe një herë dhe me më shumë theks se më parë, detyrën e madhe të tyre, të mbrojnë dhe të mbështetin popullin e shtypur e të privuar palestinez. Ata që po luftojnë dhe po vuajnë nga padrejtësia, brenda territoreve të pushtuara, duhet ta dinë se shpresa e vetme për çlirimin e Palestinës dhe çrrënjosjen e qeverisë pushtuese, janë muxhahidinët brenda Palestinës. Ata duhet ta dinë dhe ta ndiejnë se popujt në mbarë botën islame i kujtojnë dhe i mbështetin ata.

Nëse duam që ata muxhahidinë të shtypur, që janë bërë si të huaj në shtëpitë e tyre, të ndiejnë një mbështetje të tillë, atëherë, në mbarë botën islame, duhet të mbahen tubime e manifestime popullore.

Dita Botërore e Kudsit nuk është thjesht një thirrje për të mbrojtur një popull të privuar e të shtypur. Ajo është simboli i rezistencës dhe i luftës kundër arrogancës globale.

Ringjallja e Ditës së Kudsit

Bota islame duhet ta përkujtojë Ditën Botërore të Kudsit. Ka grupe myslimane që nuk i lejojnë disa qeveri, që e kanë shitur veten për ta shkrirë apo për ta mbyllur çështjen palestineze moment pas momenti, përmes atmosferës së qetë dhe heshtjes artificiale që kanë krijuar, duke e lënë çështjen palestineze në erërat e harresës. Nuk duhet të harrohet tradhtia e qeverive, që ranë dakord me entitetin pushtues dhe sakrifikuan palestinezët. Kjo nuk është çështje e vogël.

Ringjalleni Ditën e Kudsit dhe nderojeni atë. Sigurisht që mediet botërore nuk e pasqyrojnë këtë manifestim të madh islam. Të burgosurit palestinezë, në burgjet izraelite, na thonë se parullat tuaja, pjesëmarrja juaj, grushtet tuaja të shtrënguara, që shprehin qëllimet tuaja dhe vendosmëria juaj e sinqertë, na bëjnë të ndihemi të fortë, të aftë dhe të palëkundur. Ata që janë pas mureve të burgjeve sioniste, nuk duhet të ndihen të vetmuar, sepse vetëm kështu mund të qëndrojnë të patundur.

Burrat dhe gratë që përballen me sulmet e egra dhe të tmerrshme sioniste në rrugicat dhe rrugët e Jerusalemit, në Rripin e Gazës dhe në të gjitha qytetet e pushtuara

palestineze, duhet të ndiejnë se ju qëndroni pas tyre, në mënyrë që ata të mund të rezistojnë. Sigurisht që ka edhe detyra që bien mbi supet e qeverive.

Ndikimi i Ditës së Kudsit

Nëse bota islame e ringjall këtë ditë, në kuptimin e vërtetë të fjalës, dashtë Zoti, dhe përfiton nga ajo, për të lëshuar thirrje kundër sionistëve pushtues, atëherë armiku do të mposhtet me një disfatë të madhe dhe do të detyrohet të tërhiqet.

Duke marrë pjesë në ringjalljen e Ditës së Kudsit, populli iranian do të dëshmojë kuptimin e përfitimit nga kjo ditë dhe mundësinë për të shpallur qëndrimin e tij për çështjen palestineze. Palestinezët e shtypur e kanë kuptuar se, në anë të ndryshme të botës, ka nga ata që tregojnë simpati dhe interes për çështjen e tyre. Kjo simpati duhet të forcohet dhe presioni mbi Izraelin duhet të rritet. Kombet dhe popujt myslimanë, në të gjithë botën, duhet të ofrojnë ndihmë dhe mbështetje për palestinezët.

Bota islame duhet të jetë e vëmendshme ndaj çështjes së Palestinës dhe të mos e harrojë atë. Palestina është e palestinezëve dhe ata kanë të drejtë të vendosin vetë për fatin e saj dhe të tyre.

Republika Islamike e Iranit mbështet dhe përkrah frontin e rezistencës palestineze. Ne e kemi thënë këtë vazhdimisht dhe kemi vepruar siç kemi thënë.

Në mbyllje të fjalës sime, i dërgoj përshëndetjet e mia shpirttrave dëshmorë të Palestinës dhe qëndroj i përlur para familjeve të tyre të palëkundura. I përshëndes të burgosurit e palëkundur, me vullnet të fortë, në burgjet e pushtuesit. U shtrëngoj duart fraksioneve të rezistencës palestineze, të cilat kanë marrë përsipër pjesën më të madhe të kësaj përgjegjësie. I bëj thirrje botës islame, veçanërisht brezit të ri, të jetë i pranishëm në arenat e krenarisë dhe të nderimit.

Paqja qoftë mbi të gjithë arabët e lirë, veçanërisht mbi rininë e tyre!

Paqja qoftë mbi popullin rezistent palestinez dhe mbi jerusalemët e vendosur në xhaminë Al-Aksa!

Paqja qoftë mbi dëshmorët e rezistencës dhe familjet e muxhahidëve, që sakrifkuan jetën në këtë rrugë!



KËSHILLA TË VYERA

NGA

IMAM SEJID ALI KHAMENEI

RRETH MUAJIT TË RAMAZANIT

DHE AGJËRIMIT

1- Të dashurit e mi!

Ju këshilloj të keni frikë nga Allahu! Agjërimi është nder dhe begati e madhe e Allahut. Në Kur'an thuhet: **“O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat.”**¹ E lus Allahun e Madhëruar, që në këtë muaj, muajin e mikpritjes hyjnore, ta bekojë mbarë umetin islam, kudo që ndodhet. Prej detyrave që i nevojitet njeriut, në jetën e tij, është edhe agjërimi, siç është namazi dhe përmendjen e Allahut.

2- Të dashurit e mi!

Ju porosis ta lexoni e të thelloheni në Hytben e të Dërguarit më të madh (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), të cilën e ka mbajtur në pritjen e muajit të begatë të Ramazanit, që është e mbushur me mëshirë dhe bekime të shumta hyjnore, sepse ka shumë mësim. Në këtë muaj, Allahu na fton në mikpritjen e Tij bujare, që të jemi në mesin e njerëzve të Tij të nderuar.

3- Të dashurit e mi!

Vallë, kush janë njerëzit e mikpritjes së Allahut dhe kush janë të nderuarit e Tij? Ata janë besimtarët besnikë ndaj Allahut në të gjitha moralet, sjelljet e tyre, në zemrat, sinqeritetin dhe ndjenjat e tyre. Allahu i Madhëruar, me dashamirësinë e Tij, na thërret që të mbarësohemi në agjërimin tonë, që ta pastrojmë e ta forcojmë më shumë besimin tonë. Jo vetëm kaq, por edhe për të vërtetuar lidhjen tonë praktike me Allahun e Plotfuqishëm. Duhet të përfitojmë çdo mundësi dhe nga të gjitha begatitë dhe bukuritë shpirtërore të muajit të Ramazanit.

4- Të dashurit e mi!

Agjërimi i urdhëruar nga Allahu, në realitet, është fisnikërim dhe bekim hyjnor. Është mundësi shumë e çmuar për ata që mbarësohen të agjërojnë. Sigurisht, që agjërimi nuk është i zbrazët nga vështirësitë, madje të gjitha veprat e begata e të bekuara, si dhe veprimet e dobishme, përmbajnë vështirësi. Personi që nuk i duron vështirësitë, nuk e arrin qëllimin e dëshiruar. Këto vështirësi, me të cilat përballet njeriu gjatë agjërimit, nuk është asgjë në këmbim të asaj që është e dobishme për të. Kjo, sepse ai shpenzon pak dhe merr shumë.

5- Të dashurit e mi!

Nëse do ta përkufizonim me një fjali muajin e Ramazanit, themi se ai është muaji i mundësive. Ka shumë mundësi për ju dhe për mua në këtë muaj. Nëse ne do të përfitojmë ashtu siç duhet nga këto mundësi, do të kemi një kapital të madh dhe shumë të vlefshëm.

6- Të dashurit e mi!

Mundësia e muajit të Ramazanit është e çmuar dhe duhet të shfrytëzohet për të praktikuar largimin nga mëkatet. Disa të rinj, shpesh, më kërkojnë që gjatë vizitës që bëjnë tek unë, të lutem për ta, që të ndalojnë veten nga kryerja e mëkateve. Nuk ka dyshim se lutja është një gjë e mirë dhe e nevojshme, por largimi nga kryerja e mëkateve kërkon që njeriu të ketë vullnet, pasi duhet të vendosë ta lërë mëkatin dhe, kur ai vendos, kjo punë bëhet shumë e lehtë. Shmangia e mëkateve, në fillim, shfaqet para syve të njeriut si një mal, por, pas vendosmërisë për largimin prej tyre, shfaqet si një lëndinë e sheshtë. Muaji i Ramazanit është mundësia më e mirë për ta praktikuar këtë punë.

7- Të dashurit e mi!

Disa njerëzve nuk u jepet kurrë mundësia që t'i përkushtohen thirrjes së Allahut në këtë muaj të begatë dhe as nuk përfitojnë nga kjo mikpritje. Pavëmendshmëria dhe shqetësimi i tyre me punët materiale të kësaj bote i bën ata që të mos e kuptojnë ardhjen e muajit të Ramazanit dhe përfundimin e tij. Ata janë si ai person që e ftojnë në një mikpritje shumë të madhe, plot mirësi e bekime dhe ai nuk gjen mundësinë të marrë pjesë në të.

8- Të dashurit e mi!

Agjërimi, në vetvete, është të drejtuarit kah Allahu, përmendje e Tij dhe lutje që shpesh tërheqin zemrat gjatë këtij muaji. Prandaj, përfitoni sa më shumë nga kjo tryezë dhe përgatiteni veten tuaj për këtë muaj.

9- Të dashurit e mi!

Muajt Rexheb dhe Sha'ban janë muaj që e përgatisin zemrën e njeriut për të hyrë në muajin e Ramazanit dhe vetëm pak ditë kanë mbetur nga muaji Sha'ban. Përfitoni nga këto pak ditë. Kërkojini Allahut të Plotfuqishëm, drejtojini zemrat tuaja të pastra drejt Tij dhe flisni me Të.

10- Të dashurit e mi!

Nuk ka gjuhë të veçantë për të folur me Allahun e Plotfuqishëm. Imamët tanë të pagabueshëm, të cilët u ngjitën në shkallët e afërsisë me Allahun, biseduan me Allahun me gjuhë të dallueshme dhe na kanë mësuar mënyrën se si të flasim me Të. Këtë mësim e gjejmë te Munaxhat Sha'banijeh, në lutjet e muajt Rexheb, si dhe në lutjet e muajit Ramazan, të cilat kanë një përmbajtje fisnike e madhështore.

11- Të dashurit e mi!

Unë ju ftoj të gjithëve, që në këto ditë, t'i drejtoheni lutjes dhe namazit, të angazhoheni në agjërime dhe të përfitoni nga ditët dhe netët e muajit të Ramazanit.

12- Të dashurit e mi!

Ndërtimi i personalitetit është mësimi më i madh në muajin e Ramazanit. Ndoshta një nga bekimet më të mira hyjnore është se Allahu do të na ndihmojë të gjithëve që të ruajmë shkaqet e mëshirës së Tij në veten tonë deri në muajin e ardhshëm të Ramazanit.

13- Të dashurit e mi!

Mëshira hyjnore që zbret në muajin e bekuar të Ramazanit, e ka bazën te veprat e mira që keni pasur fatin t'i kryeni në këtë muaj të bekuar.

14- Të dashurit e mi!

Në muajin e Ramazanit arrihet kthimi te Allahu i Madhëruar, dashamirësia ndaj të varfërve, mbajtja e lidhjeve farefisnore, mirësia ndaj të dobët, pastërtia dhe devotshmëria.

15- Të dashurit e mi!

Vërtet, muaji i Ramazanit është muaji i dhembshurisë dhe i kthimit të Allahu Fuqplotë. Në këtë muaj, zemrat zbuten dhe shpirtrat ndriçohen me dritën e Allahut, me mirësitë dhe me mëshirën e Tij dhe njeriu arrin sukses në kryerjen e veprave të mira.

16- Të dashurit e mi!

Përpjekja e myslimanit në këtë muaj duhet të përqendrohet në përfitimin maksimal nga kjo mikpritje hyjnore dhe në fitimin e mëshirës dhe të faljes së Allahut. Unë ju porosis, që të kërkonit falje për mëkatet, për gabimet dhe për gjynahet tuaja, qofshin ato të vogla apo të mëdha.

17- Të dashurit e mi!

Është shumë e rëndësishme, që në këtë muaj t'i pastrojmë zemrat tona dhe t'i lajmë ato nga papastërtitë dhe ndotjet. Kjo arrihet duke kërkuar falje. Për këtë arsye, në shumë hadithe thuhet se lutja më e mirë ose kreu i lutjeve është kërkitimi i faljes nga Allahu. Edhe i Dërguari më i nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili është njeriu më i lartë e më i përkryer, i kërkonte falje Allahut.

18- Të dashurit e mi!

Ndonjëherë ne bëjmë gabime me veten tonë. Kur mendojmë të kërkojmë falje, mëkatet tona, indiferenca, ndjekja e dëshirave tona, shkelja e kufijve, padrejtësia ndaj vetvetes dhe padrejtësia ndaj të tjerëve mishërohen para nesh.

Allahu i Madhëruar i ka premtuar personit që i kërkon falje Atij, me sinqeritet dhe pendohet sinqerisht për mëkatin e tij, se ai do ta gjejë Allahun Falës dhe Mëshirëplotë. Kjo është dobia e kërimit të faljes.

19- Të dashurit e mi!

Qëndroni të fortë në rrugën e Allahut, pas muajit të Ramazanit dhe bëni të mira, ashtu siç vepruat në muajin e Ramazanit! Le të marrim mësim nga muaji i Ramazanit për një vit të tërë. Ky është shpërblimi më i madh hyjnor. Allahu na e dhuron një sukses të tillë. Le t'i kërkojmë Allahut kënaqësi, mëshirë, pranim, falje dhe mirësi, sepse ajo është festa e vërtetë!

20- Të dashurit e mi!

Ajo që dua të them, është se mësimi më i madh në muajin e Ramazanit është vetëndërtimi dhe hapi i parë dhe i rëndësishëm në rrugën e vetëndërtimit është që njeriu ta shikojë veten, moralin dhe sjelljen e tij me një sy kritik dhe t'i shohë të këqijat e tij, saktë dhe qartë. Pastaj të bëhet përpjekje për të shpëtuar prej atyre të këqijave. Kjo është diçka që ne mund ta realizojmë, pasi është një detyrë mbi supet tona.



21- Të dashurit e mi!

Kini mëshirë për njëri-tjetrin, që Allahu t'ju mëshirojë. Ata që kanë pushtet, të mos i shtrijnë duart e tyre për të bërë agresion ndaj interesave dhe pasurisë së të tjerëve. Të mos përfitojnë nga ata që kanë inteligjencë, zgjuarsi, aftësi, forcë, përgjegjësi të ndryshme për të sulmuar të tjerët.

22- Të dashurit e mi!

Le të bëhemi rob të Allahut, të sillemi mirë me robtë e Allahut, t'u bëjmë mirë atyre dhe të jemi të drejtë ndaj tyre. Nëse jemi të tillë, atëherë Krijuesi do të na mbulojë me shiun e mëshirës dhe të mirësisë së Tij dhe Ai do të na pastrojë nga çdo e keqe. Sigurisht, kjo është detyrë e të gjithëve, që të ndërtojmë veten tonë, të shtypim epshet dhe të heqim dorë nga agresioni ndaj të tjerëve.

23- Të dashurit e mi!

Allahu i Madhëruar e pranon pendimin nga robtë e Tij. Kërkimi i faljes është kthim te Allahu dhe largim nga mëkatet dhe shkeljet. Allahu i Madhëruar e pranon pendimin, nëse kërkimi i faljes është i vërtetë dhe i sinqertë. Dijeni se është e kotë që njeriu të thotë me gjuhë: “Unë kërkoj falje nga Zoti, kërkoj falje nga Zoti, kërkoj falje nga Zoti”, ndërsa mendja e tij është në një vend tjetër. Kjo nuk është kërkim falje.

24- Të dashurit e mi!

Muaji i Ramazanit është si shiu i mëshirës që bie mbi këtë tokë. Ai lan mëkatet që kanë bërë duart tona. Muaji i Ramazanit duhet të na bëjë të ndiejmë përgjegjësinë që Islami dëshiron për të gjithë myslimanët, lidhur me çështjen e ndjeshme të varfërisë dhe të të varfërve. Adhurimi i agjërimit, si dhe adhurimet e tjera, rrotullohen të gjitha rreth boshtit të luftës së njeriut kundër dëshirave dhe tekave të tij. Agjërimi me nijet të pastër është xhevahiri ndriçues, që e lartëson njeriun dhe e zbukuron me fisnikëri shpirtin e tij.

25- Të dashurit e mi!

Të gjithë muajt janë muajt e Allahut, por, kur Krijuesi dhe Sunduesi i ekzistencës përcakton një pjesë të ekzistencës dhe ia atribuon vetes së Tij, kjo do të thotë se Ai, asaj pjese të ekzistencës, i kushton kujdes dhe rëndësi të veçantë. Dhe një nga ato pjesë, që Allahu ia atribuon Vetes së Tij, është muaji i Allahut, muaji i Ramazanit. Ky emërtim mjafton, për të kuptuar madhësitinë e muajit të Ramazanit.

26- Të dashurit e mi!

Kur'anî Famëlartë është një nga ato tryeza të muajit të begatë të Ramazanit. Sa më shumë të përfitoni nga kjo tryezë, aq më e fortë do të jetë struktura juaj morale dhe do të jeni në gjendje të përballoni vështirësitë në rrugën e përsosmërisë dhe të lartësisë. Si rrjedhim, lumturia do të jetë më afër jush. Shumica e fatkeqësive e umetit islam vjen nga largimi prej Kur'anit. Ai nuk është libër për lexim nëpër qoshe, por është libër për veprim, njohje dhe dituri. Kur'anî duhet të pasqyrohet në veprime, në sjelljen, në moralin tonë, gjatë gjithë jetës.

27- Të dashurit e mi!

Muaji i Ramazanit është muaji i prangosjes dhe i ndalimit të dëshirave njerëzore. Ky ushtrim për një muaj të tërë, në fakt, është një kurë për dhimbjet e mëdha të njerëzve. Sigurisht, shkeljet, tejkalimet dhe tirania e nefsit të njeriut bëjnë që ditët tona të jenë ditë të vështira. Muaji i Ramazanit ndihmon në mposhtjen e dëshirave, tekave dhe epsheve.

28- Të dashurit e mi!

Fryti kryesor i muajit të Ramazanit është devotshmëria. I Plotfuqishmi thotë në Kur'an: **“Që të bëheni të devotshëm.”**¹ Kuptimi i devotshmërisë është ajo që thotë një poet: “Dora që mban frerët e nefsit”. Ndonjëherë ne mund të jemi në gjendje të mbajmë frerët e të tjerëve. Por krenari e plotë është të mbajmë frerin e vetes sonë dhe të kontrollojmë brutalitetin dhe pamaturinë e saj. Devotshmëri (tekua) do të thotë të mbikëqyrësh veten në Rrugën e Drejtë të Allahut.

29- Të dashurit e mi!

Muaji i Ramazanit është muaji i dorëzimit dhe i nënshtrimit, që do të thotë t'i dorëzohesh dhe t'i nënshtrohesh Allahut. E përse një i ri apo e re e duron urinë, etjen dhe qëndron kundër të gjitha instinkteve që e çojnë drejt pasioneve dhe dëshirave? Ata e bëjnë këtë për zbatuar urdhrin e Allahut dhe dorëzohen para Tij. Ky është nënshtrim i vërtetë ndaj Allahut të Lartësuar. Myslimani nuk e gjen në asnjë ditë të zakonshme të vitit gjithë këtë nënshtrim ndaj Allahut, siç e gjen në ditët e muajit të Ramazanit. Pra, muaji i Ramazanit është muaji i nënshtrimit dhe muaji i dorëzimit ndaj Allahut Fuqiplotë.

30- Të dashurit e mi!

Namazi i Fitër i Bajramit, në një kuptim, do të thotë falënderim për këtë lindje të re. Në namazin e Fitër Bajramit, e lusim disa herë Allahun e Madhëruar, duke thënë: “Na fut ne në të gjitha të mirat që ke futur Muhamedin dhe familjen e tij! Na largo nga të gjitha të këqijat, prej të cilave ke larguar Muhamedin dhe familjen e tij. Bekimet e tua qofshin mbi Muhamedin dhe familjen e tij të nderuar!”.

Ne, në ditën e Fitër Bajramit, e caktojmë këtë qëllim të madh për vete dhe e lusim Allahun e Madhëruar, që të na e realizojë këtë qëllim. Natyrisht, që ne e kemi për detyrë të bëjmë përpjekje për të qëndruar në Rrugën e Drejtë. Kjo është pikërisht devotshmëria e bekuar.

شهر رمضان مدرسة الحياة المعنوية

آية الله العظمى السيد علي الخامنئي دام ظله

تيرانا 2023

اسم الكتاب: شهر رمضان مدرسة الحياة المعنوية

المؤلف: آية الله العظمى السيد علي الخامنئي دام ظلّه

المترجم: الحاج الشيخ ولنت مریا

التصحیح الأدبي: یویدا کولا

التصحیح اللغوی: ویولسا کارای

الاخراج النهائي و تصمim الغلاف: صبریه فزا

ناشر: جمعية النسیم - تیرانا - ألبانیا